



Republika e Kosovës	Republika Kosovo • Republic of Kosovo
Institucioni i Avokatit të Popullit	Institucija Ombudsmana • Ombudsperson Institution
Nr./Br./No.	02112022
Nr.i fq/Br.str./Nr.pg.	14104/22
Data/Datum/Date:	14/04/22



Republika e Kosovës • Republika Kosovo • Republic of Kosovo
Institucioni i Avokatit të Popullit • Institucija Ombudsmana • Ombudsperson Institution

RAPORT

I

MEKANIZMIT KOMBËTAR PËR PARANDALIMIN E TORTURËS I AVOKATIT TË POPULLIT PËR VIZITËN NË QENDRËN KORREKTUESE NË DUBRAVË

Për: Znj. Albulena Haxhiu, ministre
Ministria e Drejtësisë

Z. Rifat Latifi, ministër
Ministria e Shëndetësisë

Kopje: Znj. Duda Balje, kryetare
Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, për Persona të
Pagjetur dhe Petacione

Z. Ali Gashi, drejtor i përgjithshëm
Shërbimi Korrektues i Kosovës

Znj. Zyrafete Imeraj, drejtoreshë
Qendra Korrektuese në Dubravë

Z. Milazim Gjocaj, drejtor
Departamenti Shëndetësor në Burgje

Z. Habit Hajredini, drejtor
Zyra e Kryeministrat - Zyra për Qeverisje të Mirë

Prishtinë, më 14 prill 2022

HYRJE

Në pajtim me nenin 135, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe me nenin 17 të Ligjit nr.05/L-019 për Avokatin e Popullit, Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës vizitoi Qendrën Korrektuese në Dubravë.

Mekanizmi Kombëtar për Parandalim të Torturës (më tej: MKPT), bazuar në nenin 17 të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, mund t'i vizitojë, në çdo kohë dhe pa paralajmërim, të gjitha vendet ku mbahen personat e privuar nga liria, përfshirë stacionet policore, qendrat e paraburgimit, burgjet, vendet ku mbahen të huajt e privuar nga liria, qëndrimi i të cilëve në Republikën e Kosovës bie ndesh me ligjet në fuqi dhe të cilët janë subjekt i kthimit me forcë nga Republika e Kosovës, si dhe institucionet psikiatrike dhe ato të kujdesit social.

Bazuar në këtë mandat, MKPT-ja, nga data 21 deri më 23 shkurt 2021, ka vizituar Qendrën Korrektuese në Dubravë (më tej: QKD).

Qëllimi i vizitës

Qëllimi i kësaj vizite ishte vlerësimi i respektimit të të drejtave themelore të njeriut të të burgosurve, të cilat u garantohen me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, me ligjet e aplikueshme në Republikën e Kosovës, si dhe me standartet ndërkombëtare përmbrojtjen e të drejtave të personave të privuar nga liria.

Përbërja e grupit monitorues

1. Ekipi monitorues përbëhej si në vijim:

- Avokati i Popullit
- Zëvendësja e Avokatit të Popullit
- Drejtoresha e MKPT-së
- Këshilltari i lartë juridik për parandalim të torturës
- Këshilltarja juridike për parandalim të torturës
- Këshilltarja-mjeke
- Këshilltarja-psikologe
- Këshilltarja-punëtore sociale

Bashkëpunimi i autoriteteve me MKPT-në gjatë vizitës

Gjatë vizitës së MKPT-së të realizuar në QKD, personeli i shërbimit korrektues dhe personeli i Departamentit Shëndetësor të Burgjeve (më tej: DShB) i ofruan ekipit monitorues bashkëpunim të plotë. Ekipi, pa vonesa, pati qasje në të gjitha vendet që i ka vizituar. Ekpit i janë siguruar të gjitha informatat e nevojshme përmes ta kryer detyrën dhe i janë mundësuar bisedat me personat e dënuar dhe me të paraburgosur, pa praninë e zyrtarëve korrektues dhe as të personelit shëndetësor.

Informimi për të drejtat e të burgosurve

2. Udhëzimi Administrativ MD-Nr. 07/2015 për Rendin Shtëpiak në Institucionet Korrektuese (Rendi Shtëpiak) përcakton obligimet e institucioneve korrektuese që menjëherë pas pranimit të sigurojnë kushte që i burgosuri të njoftohet me shkrim për të drejtat dhe detyrimet e tij. Më tej Rendi Shtëpiak përcakton se Rendi Shtëpiak dhe Ligji për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale (LESP) janë në dispozicion të të burgosurve gjatë gjithë kohës. I burgosuri, i cili nuk di shkrim dhe lexim, njoftohet gojarisht për të drejtat dhe për obligimet.¹ MKPT-ja gjatë vizitës ka vërejtur se të gjithë të pranuarit në QKD njoftohen për të drejtat e tyre në qendrën korrektuese. Po ashtu, në disa pavijone të QKD-së, MKPT-ja ka vërejtur se janë vendosur njoftime për ndihmë juridike falas ku janë vendosur numra telefoni dhe njoftime të tjera, nga të cilat mund të përfitojnë të burgosurit. Mirëpo MKPT-ja inkurajon autoritetet e QKD-së që vazhdimisht të kujdesen që në të gjitha pavijonet e QKD-së të vendosen njoftimet për të drejtat e njeriut dhe për ndihmë juridike falas.

Keqtrajtimi

3. MKPT-ja gjatë vizitës në QKD intervistoi një numër të konsiderueshëm të burgosurish lidhur me keqtrajtimin fizik apo përdorimin e tepruar të forcës fizike të ushtruar nga zyrtarët korrektues apo për sjellje të autoriteteve të burgut, të cilat do të përbën shkelje të dinjitetit të të burgosurve. MKPT-ja mori vetëm një ankesë nga një i dënuar lidhur me keqtrajtimin fizik. Ekipi i MKTP-së gjatë intervistës nuk vërejti lëndime trupore tek i dënuari edhe pse ai pohon se keqtrajtimi ka ndodhur një natë më parë.
4. Mirëpo lidhur me këto pohime, MKPT-ja pas vizitës ka biseduar me drejtorin e QKD-së lidhur me këtë rast, me ç' rast është njoftuar se lidhur me këtë çështje është formuar një komision hetues dhe se MKPT-së do t'i dërgohet raporti i hetimit të brendshëm.
5. Drejtori i QKD-së, më 28 shkurt 2022, me shkresë zyrtare e njoftoj MKPT-në si në vijim: *"Lidhur më këtë rast, komisioni nuk ka gjetur ndonjë provë apo dëshmi, përmes së cilës do të mund të vërtetoheshin pretendimet e të burgosurit N.N, për përdorim të forcës ndaj tij nga ana e mbikëqyrësit apo stafit tjetër që ishin në detyrë. Kjo është vërtetuar plotësisht përmes deklaratave të stafit dhe të burgosurve të dhomës, të cilët e mohojnë një gjë të tillë."*
6. MKPT-ja ka vizituar edhe të burgosurit, të cilëve u është shqiptuar masa disiplinore e vëtmisë dhe të cilët ishin të vendosur në qeli të caktuara. MKPT-ja nuk ka marrë asnjë ankesë për keqtrajtim fizik, për përdorim të tepruar të forcës apo për shkelje të të drejtave tjera të cilat u takojnë personave në fjalë.
7. Ekipi monitorues, po ashtu gjatë vizitës, i intervistoi dhe të paraburgosurit e akomoduar në QKD, për të kuptuar më shumë lidhur me trajtimin e tyre nga pjesëtarët e Policisë së Kosovës dhe për respektimin e të drejtave të tyre themelore, që nga momenti i arrestimit. Të gjithë të paraburgosurit e intervistuar kanë pohuar se janë trajtuar në mënyrë korrekte dhe profesionale nga pjesëtarët e Policisë së Kosovës dhe se janë respektuar të drejtat e tyre themelore.

¹ Udhëzimi Administrativ MD-Nr. 07/2015 për Rendin Shtëpiak në Institucionet Korrektuese, nen 20.

8. MKPT-ja gjatë vizitës së realizuar ka vërejtur se në përgjithësi niveli i komunikimit ndërmjet zyrtarëve korrektues dhe të të burgosurve ishte në nivel të kënaqshëm.

Kushtet materiale dhe të akomodimit

9. MKPT-ja gjatë vizitës ka vërejtur se kushtet e akomodimit në QKD në përgjithësi mund të konsiderohen se janë në pajtim me LESP-në dhe me standardet ndërkombëtare për të drejtat e të burgosurve. Ekipi i MKPT-së ka vërejtur se janë kryer disa rinvime nga vetë të burgosurit në pavijone të caktuara si dhe janë bërë disa ndryshime sanitare. Ndërsa në pavijonet e tjera vazhdimisht personeli adekuat, sipas mundësisë, kujdesen që të bëjnë rinvimet e caktuara. MKPT-ja vëren se nenin 36 i LESP-së përcakton: “*Personi i dënuar ka të drejtë në strehim që i përgjigjet kushteve bashkëkohore higjenike dhe rrethanave vendore klimatike.*”²
10. Mirëpo në raste të caktuara MKPT-ja mori disa pohime nga të burgosurit se mungonte uji i ngrohtë si dhe shtypja e ujit gjatë verës është e vogël (pavijonet 1, 2, 3, dhe 4). Sipas tyre, uji i ngrohtë nuk është i mjaftueshëm për pastrim dhe mirëmbajte të higjenës. MKPT-ja vëren se nenin 38 i LESP-së përcakton: “*Me qëllim të sigurimit të higjenës së personave të dënuar dhe higjenës së lokaleve, personave të dënuarve iu sigurohet sasi e mjaftueshme e ujit të ftohtë dhe të nxeh të si dhe, artikuj adekuat për pastrim dhe tualet. Pajisjet dhe mjetet për higjenë personale sigurojnë privatësinë e mjaftueshme të dënuarit dhe ata mirëmbahet dhe pastrohen në rregull.*”³
11. Po ashtu MKPT-ja gjatë vizitës sërisht ka vërejtur se të burgosurit përdorin pajisje elektrike të improvizuara për ngrohje të ujit, të cilat mund t'i rrezikojnë seriozisht jetët e tyre. Sipas pohimeve të të burgosurve, në mungesë të ujit të ngrohtë, ata detyrohen të përdorin pajisje të tillë të improvizuara.
12. MKPT-ja gjatë monitorimit po ashtu ka pranuar disa ankesa nga të dënuarit se ka mungesë të dyshekëve dhe të jastëkëve cilësorë (pavijonet 1, 2, 5 dhe Pavijoni Gjysmë i Hapur (PGjH)). MKPT-ja aty për aty e ka shprehur shqetësimin tek zyrtarët kompetentë.
13. Edhe gjatë kësaj vizitës, MKPT-ja u ka kushtuar vëmendje të veçantë të burgosurve, të cilëve u ishte shqiptuar masa disiplinore e vëtmisë, për shkak të shkeljeve disiplinore. MKPT-ja vëren se LESP-ja përcakton se dhoma për ekzekutimin e masës disiplinore të vëtmisë duhet të ketë një hapësirë prej së paku dhjetë (10) metrash kub, pajisje sanitare, dritë natyrore, ujë të pijshëm, shtrat me çarçaf, tavolinë, karrige dhe ngrohje.⁴
14. Po ashtu, Komiteti Evropian për Parandalim të Torturës (në tekstin e mëtejshmë: KPT), lidhur me kushtet e akomodimit në qeli ku mbahet i burgosuri, të cilit i shqiptohet masa disiplinore e vëtmisë, thekson se qelitë e tillë duhet t'i plotësojnë standardet e njëjta minimale, si ato të cilat zbatohen në rastet e vendosjes së të burgosurve të tjerë. Ato duhet të janë të madhësisë adekuate, të kenë dritë natyrore, të kenë ngrohje adekuate dhe të kenë ventilim. KPT-ja më tej thekson se qelitë e tillë duhet të janë së paku të pajisura me tavolinë, me karrige adekuate, me krevat adekuat dhe me çarçaf.⁵

² Ligji nr.04/L-149 për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, neni 36, paragrafi 1.

³ Ligji nr.04/L-149 për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, neni 38, paragrafi 2.

⁴ Ligji për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, neni 111, paragrafi 2.

⁵ Komiteti Evropian për Parandalim të Torturës, Pjesë nga raporti i 21-të i Përgjithshëm, publikuar në vitin 2011, për më shumë shih në: <https://rm.coe.int/16806cccc6>, (21.5.2018).

15. MKPT-ja ka vërejtur se kushtet e vendosjes në këto qeli janë në pajtim me standardet e përcaktuara nga LESP-ja dhe me standardet e përcaktuara nga KPT-ja.⁶
16. MKPT-ja gjatë monitorimit ka vërejtur se në Pavijonin 1, saktësisht në krahun V1, me vendim të autoritetit të QKD-së është krijuar krahu i sigurisë, ku janë vendosur të dënuarit të cilëve u rrezikohet siguria nga të dënuarit e tjerë. Vendosja e të dënuarve në krahun e sigurisë bëhet pas vlerësimit nga zyrtarët kompetentë. MKPT-ja rithekson se siguria e integritetit fizik të të burgosurve është një nga përgjegjësítë madhore të institucioneve korrektuese.

Ushqimi

17. Ekipi i MKPT-së edhe gjatë kësaj vizite në QKD ka marrë një numër të konsiderueshëm ankesash nga të dënuarit, nga zyrtarët korrektaues dhe nga personali shëndetësor lidhur me cilësinë dhe sasinë e ushqimit.
18. MKPT-ja vëren se LESP-ja përcakton se i dënuari ka të drejtë për ushqim të përshtatshëm për ruajtjen e mirë të shëndetit dhe të fuqisë së tij, në tri shujta për çdo ditë, të cilat duhet të jenë të llojullojshme dhe ushqyese. Ushqimi që i jepet personit të dënuar duhet t'i përshtatet moshës dhe gjendjes së tij shëndetësore, natyrës së punës, stinës e kushteve klimatike dhe, për aq sa është e mundur, duhet t'u përshtatet kërkave të tij fetare dhe kulturore. Më tej ligji përcakton obligimin që të dënuarit t'i sigurohet ushqimi i caktuar nga mjeku.⁷
19. Po ashtu MKPT-ja vëren se edhe Rregullat e Mandelës përcaktojnë obligimin e autoriteteve që të burgosurve t'u sigurohet ushqim adekuat për shëndetin e tyre, si dhe ujë të pijshëm gjatë gjithë kohës.⁸ Në këtë drejtim, Rregullat Evropiane të Burgjeve përcaktojnë obligimin e autoriteteve që të burgosurve t'u sigurohet ushqim dietal, duke pasur parasysh moshën e tyre, gjendjen e tyre fizike, religionin dhe natyrën e punës së tyre. Ushqimi duhet të përgatitet dhe të shërbehet në kushte adekuate higjenike, kurse uji i pijshëm duhet të jetë në dispozicion gjatë gjithë kohës.⁹
20. Sipas LESP-së, kontrollin e ushqimit e bën shërbimi shëndetësor duke marrë mostrat, të cilat monitorohen për 72 orë, si dhe përkujdesen për cilësinë e ushqimit duke u bazuar në menynë ditore – javore dhe ushqimin dietal. Më 15 mars 2022, MKPT-ja ka kërkuar komentet e DShB-së lidhur me ankesat e të burgosurve dhe të stafit për cilësinë dhe sasinë e ushqimit që u shërbehet.
21. DShB-ja më 15 mars 2022 njoftoi MKPT-në se kuzhina inspektohet nga mjeku dhe çdo ditë merren mostrat e ushqimit dhe ruhen në vend të sigurt. Më tej në këtë njoftim theksohet: “*Ushqimi ne kuzhinën e QK Dubravë mbikëqyret ne vazhdimësi nga mjeket e NjShB-Dubrave. Mostrat e ushqimit merren çdo dite nga kuzhinieri dhe ruhen ne frigorifer për 72 ore. Sa i përket cilësisë dhe mënyrës se shërbimit, ka pasur raste kur cilësia nuk ka gjen ne nivel te kënaqshëm dhe për ketë është kërkuar nga Kryekuzhinieri qe te përmirësoshet cilësia. Ankesat e stafit dhe te burgosurve janë kryesisht për shijen e*

⁶ Standardet e KPT-së lidhur me kushtet e akomodimit për të burgosurit, të cilëve u shqiptohet masa disiplinore e vëtmisë, janë përcaktuar përmes Raportit të 21-të të Përgjithshëm. Për më shumë shih në: <https://rm.coe.int/16806cccc6>.

⁷ Ligji për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, neni 39, paragrafët 1 dhe 2.

⁸ Rregullat e Mandelës, Rregulli 22.

⁹ Rregullat Evropiane të Burgjeve, Rregullat 22.1 deri 22.6.

ushqimit gjë qe është e mundur te përmirësohet pasi artikujt dhe gjerat e nevojshme nuk mungojnë. Fatmirësisht deri me tanë nuk kemi pasur ndonjë helmim për te burgosur dhe staf. Kohe me pare me rekomandimin tone dhe me përkrahjen Drejtoret te QK Dubravë, materiali higjenik për kuzhine është dyfishuar.”

22. Ndërsa sa i përket ushqimit dietal, MKPT-ja ka vërejtur se bazuar në rekomandimin e mjekut, ka të burgosur të cilët marrin ushqim dietal. MKPT-ja përmes kontrollit të dokumentacionit ka vërejtur se të burgosurve u ofrohet ushqimi dietal sipas rekomandimit të mjekut.

Kuzhina e QKD-së

23. MKPT-ja gjatë vizitës në kuzhinë ka vërejtur se janë të angazhuar në punë dy kuzhinierë dhe 15 deri në 25 të burgosur. Të angazhuarit në kuzhinë, përfshirë këtu edhe të burgosurit, janë të pajisur me libreza sanitare.
24. Ekipi i MKPT-së gjatë vizitës ka vërejtur se kushtet në kuzhinë si dhe gjendja teknike e kuzhinës ishte jo e mirë. MKPT-ja ka vërejtur se pajisjet në kuzhinë janë shumë të vjetruara, afërsisht 20 vjet, dhe shpesh kanë probleme teknike, disa pajisje në kuzhinë janë jashtë funksionit, si: furra për pjekën e bukës. Personeli i kuzhinës njoftoi MKPT-në se vazhdimisht bëjnë përpjekje që këto mangësi në kuzhinë t'i mënjanojnë, mirëpo nganjëherë pa sukses.
25. Sa i përket depos, MKPT-ja ka vërejtur se depoja ku mbahet ushqimi afatgjatë ishte në gjendje të mirë dhe i ka kushtet që nevojiten për ruajtje të ushqimit dhe nuk ka lagështi. Nuk janë gjetur produkte me afat të skaduar. Por MKPT-ja ka vërejtur se në korridorin e depos ka rrjedhje të ujit nga kuzhina. Ndërsa lidhur me ashensorin në depo, MKPT-ja ka vërejtur përsëri se nuk është në gjendje të mirë, autoritetet kompetente nuk kanë ndërmarrë asnjë veprimi për rregullimin e tij. Zyra e mirëmbajtjes është në përpjekje për ta modifikuar në mënyrë që të mos rrezikohet stafi dhe të dënuarit.
26. Gjatë monitorimit MKPT-ja ka vizituar edhe lavanderinë dhe ka vërejtur se në hapësirën që përdoret për lavanderi ka rrjedhje uji nga tavani. Sipas të burgosurit, i cili ishte i angazhuar në punë, uji i cili pikon është nga banjat. MKPT-ja u njofua nga personeli se gjendja teknike është jo e mirë, makineritë prishen shpesh dhe si pasojë nganjëherë pastrimi bëhet me ujë të ftoshtë. **MKPT-ja inkurajon autoritetet e QKD-së që t'i mënjanojnë këto mangësi në lavanderi.**

Regjimi

27. Sa i përket regjimit, MKPT-ja gjatë vizitës ka biseduar me udhëheqësin e instruktorëve dhe trajnimeve, nga i cili është informuar se në kuadër të QKD-së funksionojnë tri punëtori, të cilat në fakt janë edhe qendra për trajnime profesionale, ku organizohen trajnime për saldim, për ndërtimtari, për axhustator, për zdrukthëtar, për mirëmbajtje teknike, për instalim të ujit dhe për instalim të rrymës. Në këto punëtori organizohen kurse, me kohëzgjatje prej tre muajsh. Po ashtu MKPT-ja ka vërejtur se janë rreth 260-300 të burgosur të angazhuar në punë.
28. Ekipi i MKPT-së ka vizituar edhe punëtoritë në QKD për t'u njofuar nga afër me punën dhe funksionimin e tyre. MKTP-ja vëren se në të gjitha punëtoritë nuk funksionojnë ngrohëset, për shkak se dimrit sistemi i gypave është i ngrirë. MKPT-ja mori ankesa nga

personeli dhe nga të dënuarit e pranishëm se për shkak të temperaturave të ulëta nuk ka kushte adekuate të punës në këto punëtori. Po ashtu edhe nga MKPT-ja u vërejt mungesa e ngrohëseve dhe temperaturat ishin të ulëta. Ndërsa në Punëtorinë nr. 1, MKPT-ja ka vërejtur se ka lagështi, pasi uji depërtion nga muret.

29. Sa i përket materialit për punë në punëtoritë, MKPT-ja mori ankesa nga personeli se çdo herë mungon nga një produkt për punë dhe kjo mungesë po u shkakton vështirësi dhe ndërprerje në punë.
30. Në kuadër të QKD-së funksionon edhe shkolla e mesme, në të cilën mësimin e vijojnë 37 nxënës. Shkolla është paralele e ndarë e Shkollës se Mesme Teknike "Mithat Frasheri" në Gurrakoc - Istog, drejtimi për makineri. Mirëpo ekipi i MKPT-së gjatë vizitës, nga intervistimi i të dënuarve është informuar se disa të dënuar nuk dinë shkrim-lexim. Një fakt të tillë e ka pohuar edhe udhëheqësi për programe dhe arsim.
31. Lidhur me këtë, nen 83, paragrafi 1, i LESP-së, përcakton "*Personi i dënuar ka të drejtë në shkollim fillor dhe të mesëm në pajtim me ligjin për arsimin fillor dhe të mesëm.*" Gjithashtu në ligj theksohet se përgjegjës për arsimimin fillor dhe të mesëm në institucionin korrektues është ministria kompetente për arsim. Neni 83, paragrafi 4, përcakton: "*Për personat e dënuar që nuk din shkrim lexim organizohen kurse të posaçme.*"
32. MKPT-ja vëren se të dënuarit mund të lëviznin të lirë brenda pavijoneve ku ishin të vendosur dhe kanë të drejtë për 3 orë shëtitje në ditë gjatë stinës së verës, kurse gjatë dimrit, deri në 2 orë në ditë.¹⁰ Po ashtu në kuadër të QKD-së, në dispozicion të të burgosurve është salsa e fitnesit dhe fusha e futbollit.
33. Ekipi i MKPT-së gjatë vizitës ka takuar edhe udhëheqësin për Programe dhe Regjime, nga i cili është njoftuar se kjo njësi merret me tretmanin e të burgosurve që nga pranimi, duke filluar me tretmanin themelor, standard, të avancuar dhe tretmanin gjysmë të hapur, përmes komisioneve shumëdisiplinore. Po ashtu MKPT-ja është njoftuar se në kuadër të njësisë janë mbajtur katër sesione me nga 10 seanca të programit Terapia Grupore për Menaxhimin e Zemërimit. Sesioni i parë - pjesëmarrës kanë qenë të dënuarit për veprat "Narkotik", dhe janë certifikuar gjashtë të dënuar. Sesioni i dytë – pjesëmarrës ishin të dënuarit për veprat "Grabitje" dhe janë certifikuar gjashtë të dënuar. Sesioni i tretë - pjesëmarrës ishin të dënuarit për veprat "Terrorizëm", kanë qenë katërmëdhjetë pjesëmarrës të dënuar. Sesioni i katër – është mbajtur me të burgosurit që janë të dënuar për vepra penale që kanë të bëjnë me "dhunë në familje", "vrasje" dhe janë certifikuar 12 të burgosur.
34. MKPT-ja gjatë vizitës ka vërejtur se angazhimi në punë, në aktivitete, në trajnime profesionale etj., i të burgosurve është më i madh kahasuar me periudhën e mëhershme dhe se në këtë drejtim është shënuar progres.

¹⁰ Sipas nenit 37 të Ligjit për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, të dënuarit kanë të drejtë për së paku dy orë shëtitje.

Kujdesi shëndetësor

35. MKPT-ja vëren se nen i 43 i Ligjit për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale përcakton se personi i dënuar ka të drejtë për shërbime shëndetësore pa pagës.¹¹ Po ashtu sipas LESP-së, nëse personit të dënuar të cilit nuk mund t'i ofrohet trajnim i duhur mjekësor në institucionet korrektuese, dërgohet në spitalin e burgut, në institucionet psikiatrike adekuate, ose në ndonjë institucion tjetër për përkujdesje shëndetësore.¹²
36. Ekipi i MKPT-së vizitoi spitalin e QKD-së, i cili ofron shërbime mjekësore për të burgosurit, në të cilin janë të angazhuar gjashtë mjekë të përgjithshëm të rregullt, 26 infermierë, 4 nga ta janë të angazhuar vetëm në ndërrimin e natës (12 orësh), kurse 4 të tjerë në ndërrimin e ditës (12 orësh), të tjerët janë të angazhuar me orar të rregullt nga ora 08:00-16:00, dy psikologë me orar të rregullt, një fizioterapeute dhe një farmaciste.
37. Spitali i burgut të QKD-së mbështetet nga institucionet e tjera publike shëndetësore, siç janë: Spitali Rajonal i Pejës, Emergjenca dhe Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës (ShSKUK) në tërësi. Janë 11 specializantë të ndryshëm, të cilët janë pjesë e konsultimeve që ofrohen. Po ashtu në dispozicion të spitalit janë pulmologu, radiologu, kirurgu i përgjithshëm, fiziatri, tekniku i fizioterapisë, neurologu, urologu, ORL, oftalmologu, dermatologu, tekniku i radiologjisë.
38. Transporti i të burgosurve për në institucione të tjera shëndetësore dhe anasjelltas bëhet me ambulancë të shërbimit shëndetësor, e cila është e pajisur me të gjitha pajisjet e nevojshme dhe me personel të nevojshëm.
39. MKPT-ja ka vërejtur se sëmundjet më të shpeshta janë: sistemi lokomotor (182 raste), sistemi gastrointestinal (139 raste), sindroma neurotike (129 raste), sindroma psikotike (114 raste), sëmundje kardiovaskulare (133), sëmundje të lëkurës (96) dhe të sistemit respirator (128 raste) etj. Sa i përket grupeve LGBT, MKPT-ja ka vërejtur se nuk ka të identifikuar nga autoritetet, respektivisht, asnjë i burgosur nuk u deklarua se i takon kësaj kategorie.
40. MKPT-ja ka vërejtur gjatë vizitës se gjatë vitit 2021, me terapi psikotike janë trajtuar rreth 112, kurse me atë neurotike janë trajtuar 143. Ndërsa në program të metadonit janë 16 raste. Në Repartin Psikiatrik të spitalit të QKD-së janë të shtrirë 8 persona nën përkujdesje të përhershme. Kurse në Pavijonin 7 janë pacientë të cilët janë të menaxhueshëm dhe nuk kanë nevojë për shtrirje spitalore. Edhe gjatë kësaj vizite, MKPT-ja vërejti se vazhdon të jetë sfidë prania e vazhdueshme e të burgosurve me sëmundje mendore.
41. Në dosjet shëndetësore vërehet se shërbimet psikiatrike janë duke u realizuar, por po ashtu është vërejtur përdorimi i shtuar i terapive psikotike. MKPT-ja verën se psikiatri punon çdo ditë, mirëpo ka raste kur është i angazhuar edhe në burje të tjera. Sa i përket ofrimit të shërbimeve psikologjike, MKPT-ja çdo herë ka dhënë rekomandim që në QKD të rritet numri i psikologëve, duke konsideruar se numri i të burgosurve në QKD është tepër i madh për t'u mbuluar me shërbime psikologjike vetëm prej një psikologu. MKPT-

¹¹ Ligji nr.04/L-149 për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, nen i 43, paragrafi 1.

¹² Ligji nr.04/L-149 për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, nen i 43, paragrafi 2.

ja gjatë vizitës vërejti se DShB-ja ka shtuar edhe një psikolog në QKD, duke shënuar progres në dhënien e shërbimeve psikologjike.

42. MKPT-ja ka vërejtur se në QKD gjatë vitit 2021 kishte 4 raste të vdekjeve. Sa i përket autopsisë, bëhet vetëm të rastet e dyshimita dhe atyre që ndodhin brenda 24 orësh dhe të cilat janë të papritura. Kopja e raportit të autopsisë nuk i dorëzohet shërbimit shëndetësor për t'u vendosur në dosje të pacientit.

Parandalimi i vetëvrasjeve dhe i vetëlëndimeve

43. MKPT-ja vëren se LESP-ja përcakton se një ndër qëllimet e kontrolleve të hershme mjekësore është edhe parandalimi i vetëvrasjeve dhe i vetëlëndimeve. Më tej LESP-ja përcakton se nëse personi i dënuar bën përpjekje për ta lënduar veten, ose të bëjë vetëvrasje, një ekip profesional shumëdisiplinor ndërmerr veprime të nevojshme për t'i dalë në ndihmë atij në mënjanimin e shkaqeve që e shtynë atë në tentimin për të ndërmarrë një veprim të tillë.¹³
44. Gjatë vizitës MKPT-ja ka vërejtur se shërbimi shëndetësor për t'i parandaluar vetëvrasjet dhe vetëlëndimet ndërmerr veprimet përmes kontrolleve mjekësore menjëherë pas pranimit të të burgosurit, të cilat bazohen në vlerësimin e gjendjes shëndetësore dhe pastaj duke vazhduar me vlerësimin psikologjik, si dhe sigurimi i aktivitetave sportive dhe angazhimi në punë nga drejtori i QKD-së. Nga dokumentacioni i analizuar, MKPT-ja ka vërejtur se në vitin 2021 janë evidentuar 28 vetëlëndime, 71 lëndime trupore, 6 tentim vetëvrasje, 3 lajmërimë për abuzime seksuale, 34 raste me grevë urie dhe 199 me masë disiplinore të vëtmisë.
45. MKPT-ja verën se rastet e vetëvrasjeve dhe të vetëlëndimeve trajtohen nga DShB-ja, duke u bazuar në Praktikat Standarde të Veprimit të DShB-së.¹⁴

Sëmundjet ngjitëse

46. Standardet e KPT-së përcaktojnë: “*Një shërbim i kujdesit shëndetësor në burg duhet të sigurojë që të qarkullohet rregullisht si te personeli i burgut edhe te të burgosurit informacion për sëmundjet e transmetueshme (veçanërisht për hepatitin, AIDS, tuberkulozin, infeksionet dermatologjike). Aty ku është e përshtatshme, duhet të kryhet kontroll mjekësor te ata me të cilët ka kontakte të rregullta (të burgosur të tjera, personel burgu, vizitorë) një i burgosur i veçantë.*”¹⁵
47. KPT-ja më tej përcakton: “*Përsa i përket, posaçërisht AIDS, duhet të ofrohet këshillim i përshtatshëm si përpara dhe, në se është e nevojshme, pas çdo testi kontrolli. Personeli i burgut duhet të trajnohet vazhdimisht për masat parandaluese që duhen marrë dhe qëndrimet që duhen mbajtur ndaj pozitivitetit në HIV dhe t'u jepen udhëzime të përshtatëshme lidhur me mos-diskriminimin dhe konfidencialitetin.*”¹⁶

¹³ Ligji për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, nen 47.

¹⁴ Praktikat Standarde të Veprimit të Departamentit Shëndetësor në Burgje.

Shih në: <https://msh.rks-gov.net/wp-content/uploads/2021/12/1.-Praktikat-Standarde-te-Veprimit-te-DShB-2019.pdf>

¹⁵ Komiteti Evropian për Parandalim të Torturës, Pjesë nga Raporti i 3-të i Përgjithshëm, publikuar në vitin 1993. Shih në: <https://rm.coe.int/16806ce91b> (11.3.2021)

¹⁶ Po aty.

48. Gjatë vizitës në QKD, MKPT-ja ka vërejtur se nuk ka pasur asnje rast të regjistruar me SST(AIDS), por ka vërejtur një rast me Hepatit-B, dhe 5 raste me Hepatit-C pozitiv, të cilët menaxhohen nga personeli i trajnuar, në bashkëpunim me Kliniken Infektive. Lidhur me këtë sëmundje është bërë edhe vaksinimi i personelit mjekësor dhe rivaksinimi i atyre të vaksinuar të Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës (më tej: IKShPK), ndërsa të gjithë të punësuarit e rind janë të obliguar vetë të vaksinohen në IKShPK.
49. Po ashtu, lidhur me trajtimin dhe parandalimin e TBC-së dhe HBV&HCV, DShB-ja ka lidhur marrëveshje me OJQ “KEA” për monitorim, trajnim, trajtim dhe mbështetje profesionale gjithëpërfshirëse. Po ashtu MKPT-ja ka vërejtur se DShB-ja nuk kanë prezervativë për të dënuarit.
50. Duhet cekur se MKPT-ja gjate vizitës ka vërejtur se stacionari i QKD-së plotëson nevojat minimale për dhënien e shërbimeve shëndetësore për personat e hospitalizuar, edhe pse thuhet se ka pasur rinoime, gjendja e përgjithshme e objektit nuk është e mirë as për pacientët dhe as për personelin shëndetësor. Po ashtu duhet cekur se spitali i QKD-së ka dy kate dhe posojnjë vetëm shkallë, kjo paraqet vështirësi për pacientët e sidomos për personat me aftësi të kufizuar. Spitali është i ndarë në dy reparte: Reparti Psikiatrik dhe Reparti i Sëmundjeve Organike.
51. MKPT-ja ka vërejtur se Pavijoni 7 është pjesë e shërbimit shëndetësor ku janë të vendosur të burgosurit me probleme të ndryshme, por lehtë të menaxhueshëm, por kanë nevojë për përkujdesje shëndetësore.

Kontrollimi sistematik i përdorimit/abuzimit të drogës, të alkoolit dhe të duhanit

52. Kontrollimi sistematik i përdoruesve dhe abuzuesve të drogës, të alkoolit dhe të duhanit bëhet me identifikimin e tyre me rastin e pranimit, duke vazhduar përmes monitorimit të mëtejmë që nënkupton informimin lidhur me pasojat e përdorimit, trajtimit me terapi adekuate, e cila duhet të përdoret vazhdimesht dhe përmes trajnimit të personelit për të punuar me këtë kategori. Po ashtu, duke bashkëpuuar me institucionet e tjera të cilat merren me trajimin e kësaj kategorie.
53. MKPT-ja ka vërejtur se në dispozicion të të burgosurve është programi me metadon, i cili realizohet sipas protokollit të përcaktuara në Procedurën Standarde të Veprit (më tej: PSV); i trajnimeve dhe mbështetjes e cila ofrohet nga Qendra për Këshillim dhe Trajtim të Varësisë “Labirint” për drogat dhe trajtimin e përdoruesve në pajtim me protokollet nacionale për të burgosur të sapopranuar, të cilët identifikoohen si të tillë, si dhe për trajtim të atyre të cilët dalin nga burgu dhe vazhdojnë me program të metadonit.
54. Sa i përket furnizimit me barna, MKPT-ja ka vërejtur se ka furnizim të mjaftueshëm me barna. Gjatë vizitës nuk janë gjetur barna me afat të skaduar. Të gjitha barnat me afat të skaduar janë larguar dhe paketuar për asgjësim dhe janë vendosur në depo. **Mirëpo ende nuk janë asgjësuar këto barna.** Shpërndarja e ilaçeve bëhet nga infermierët dhe bëhet në mënyrën që ofron konfidencialitet.
55. Sa u përket të dënuarve me masë disiplinore të vëtmisë, MKPT-ja ka vërejtur se personeli mjekësor nuk merr pjesë në vendimmarje me rastin e shqiptimit të masës disiplinore ndaj të burgosurit, por vetëm raporton për gjendjen shëndetësore të të burgosurit në fjalë. Bazuar në dokumentacionin relevant, mjeku viziton çdo dy-tri ditë të burgosurin e

ndëshkuar me masë disiplinore të vëtmisë, kurse infermieri e viziton së paku një herë në ditë dhe ia mat parametrat vitalë.

56. MKPT-ja verën se nen i 112, paragrafi 3, i LESP-së përcakton: “*Personi i dënuar në vetmi vizitohet nga mjeku çdo ditë kurse nga drejtori i institucionit korrektues dhe punëtori social një herë në shtatë (7) ditë, apo kur e kërkon nevoja edhe më shpesh.*” MKPT-ja inkurajon drejtorin e QKD-së dhe personelin mjekësor të DShB-së që në rastet e të dënuarve me masë disiplinore, të veprojnë sipas LESP-së.
57. Monitorimi dhe inspektimi i zbatimit të dispozitave nga fusha e shëndetësisë bëhet nga organet e Ministrisë së Shëndetësisë - Inspektorati, MKPT-ja, OJQ-të të cilat nënshkruajnë marrëveshje me organet kompetente, si dhe nga mekanizmat ndërkombëtarë monitorues, siç janë: KPT-ja, Kryqi i Kuq Ndërkombëtar etj. Sa u përket regjistrave, MKPT-ja ka vërejtur se shërbimi shëndetësor përdor regjistra fizikë dhe elektronikë.
58. MKPT-ja ka vërejtur se Pavijoni 7 është pjesë e shërbimit shëndetësor ku janë të vendosur të burgosurit me probleme të ndryshme, por lehtë të menaxhushëm, por kanë nevojë për përkujdesje shëndetësore.

Rëndësia e kontrolleve mjekësore të të burgosurve të sapopranuar

59. KPT-ja vazhdimisht thekson rëndësinë e kontrollimit mjekësor të të burgosurve të sapopranuar, veçanërisht në institucionet që përbëjnë si pikë hyrjeje në sistemin e burgjeve. Një kontrollim i tillë është esencial, veçanërisht për t'i parandaluar vetëvrasjet dhe përhapjen e sëmundjeve ngjitime (siç janë tuberkulozi, hepatiti B/C, HIV).
60. Sipas KPT-së, shërbimet mjekësore të burgut mund të japid kontribut domethënës në parandalimin e keqtrajtimit fizik gjatë periudhës menjëherë para burgosjes, domethënë në periudhën kur personat janë në mbajtje nga agjencitë e zbatimit të ligjit, përmes regjistrimit sistematik dhe me kohë të lëndimeve dhe, kur kjo është e përshtatshme, përmes sigurimit të informatave për autoritetet relevante.¹⁷
61. LESP-ja¹⁸ dhe Praktika Standarde e Veprimeve (PSV)¹⁹ e DShB-së përcaktojnë obligimin e autoriteteve që i burgosuri i sapopranuar t'i nënshتروhet kontrollit mjekësor brenda 24 orëve nga momenti i pranimit.
62. Obligime të tillë përcaktohen edhe me aktet ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të të burgosurve, siç janë: Rregullat e Mandelës²⁰, Rregullat Evropiane të Burgjeve²¹ dhe Rregullat e Kombeve të Bashkuara për Mbrojtjen e të Miturve të Privuar nga Liria.²²

¹⁷ Komiteti Evropian për Parandalim të Torturës, Raporti i 26-të i Përgjithshëm, paragrafi 72, në: <https://rm.coe.int/168070d0c8>.

¹⁸ Ligji nr. 04/L-149 për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, neni 31.

¹⁹ Praktika Standarde e Veprimeve, pika 1. Shih në: <https://msh.rks-gov.net/wp-content/uploads/2013/11/1.-Praktikat-Standarde-te-Veprimit-n%C3%AB-DShB.pdf>.

²⁰ Rregullat e Mandelës, Rregulli 34. Shih në: https://www.unodc.org/documents/justice-and-prison-reform/GA-RESOLUTION/E_ebook.pdf.

²¹ Këshilli i Evropës, Rekomandimi (2006) 2 i Këshillit të Ministrave për Shtetet Anëtare mbi Rregullat Evropiane të Burgjeve, pika 42.1. Shih në: <https://rm.coe.int/CoERMPublicCommonSearchServices/DisplayDCTMContent?documentId=09000016804c221d>.

²² Rregullat e Kombeve të Bashkuara për Mbrojtjen e të Miturve të Privuar nga Liria, pika 27, në: https://www.ohchr.org/Documents/ProfessionalInterest/res45_113.pdf.

63. Bazuar në pohimet e të burgosurve dhe në dokumentacionin relevant mjekësor, të burgosurit e sapopranuar kontrollohen brenda afatit prej 24 orësh, nga momenti i pranimit në QKD. Këto kontolle nënkuptojnë një kontroll të përgjithshme, sipas PSV-së së DShB-së.

Konfidencialiteti i shërbimeve mjekësore

64. Konfidencialiteti i shërbimeve mjekësore parashihet me PSV-në,²³ e miratuar nga Ministria e Shëndetësisë; me LESP-në²⁴; me standartet e KPT-së;²⁵ si dhe me aktet ndërkontrollare, siç janë: Rregullat e Mandelës²⁶ dhe Rregullat e Kombeve të Bashkuara për Mbrojtjen e të Miturve të Privuar nga Liria.²⁷
65. Për më shumë, edhe standartet e KPT-së përcaktojnë se të gjitha ekzaminimet mjekësore të të burgosurve duhet të kryhen në atë mënyrë që të mos shihen dhe të mos dëgjohen nga zyrtarët korrekta, përvèç në rastet kur mjeku e kërkon një gjë të tillë.
66. Neni 25, paragrafi 3, i Udhëzimit Administrativ për Rendin Shtëpiak në Institucionet Korrekta, shprehimisht përcakton: “*Mjeku bënë vizitën mjekësore në kushte të konfidencialitetit mjekësor dhe normave etike profesionale.*”
67. Bazuar në informata nga stafi i shërbimit shëndetësor dhe nga intervistat me të burgosurit, shërbimet shëndetësore, në përgjithësi, jepen pa praninë e zyrtarëve korrekta.

Personeli i Qendrës Korrekta në Dubravë

68. MKPT-ja gjatë kësaj vizite, por edhe vizitat të mëhershme, ka marrë shumë ankesa nga personeli korrekta lidhur me kushtet e punës si dhe me numrin e vogël të zyrtarëve korrekta në raport me të burgosurit. Një nga ankesat e shumta është edhe mosfurnizimi me uniforma dhe pajisje të tjera të domosdoshme për ta kryer punën e tyre.
69. Lidhur me këto shqetësimë të zyrtarëve korrekta, MKPT-ja, më 11 mars 2022, me shkresë zyrtare i është drejtuar Shërbimit Korrekta të Kosovës (ShKK).
70. ShKK-ja, më 21 mars 2022, e njoftoi MKPT-në, si në vijim: “*Si Autoritet Kontraktues, Shërbimi Korrekta i Kosovës (SHKK) me datën 08.03.2021 ka tenderuar në procedurë të hapur në vlerë të mesme aktivitetin e prokurimit me titull: “Furnizim me uniforma për stafin korrekta,, me numër te prokurimit: 33600-21-897-1-1-1 sipas Nenit 40 të Ligjit Nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237 Prokurimin Publik i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237 (LPP). Mirëpo pasi qe komisioni i vlerësimit ka bere vlerësimin, krahasimin dhe ekzaminimin e ofertave ka ardhur në përfundim se operatoret ekonomik kanë dorëzuar oferta të papërgjegjshme në aspektin teknik duke anuluar tenderin. Por pas këtij vendimi AK-SHKK ka pranuar*

²³ Praktika Standarde e Veprimit, pika 11. Shih në: <https://msh.rks-gov.net/wp-content/uploads/2013/11/1.-Praktikat-Standarde-te-Veprimit-n%C3%AB-DShB.pdf>.

²⁴ Ligji për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, nen 49.

²⁵ Standartet e KPT-së, publikuar në vitin 2018, paragrafit 50 dhe 51. Për më shumë shih në: <https://rm.coe.int/16806ce943>.

²⁶ Rregullat e Mandelës, Rregulli 26, pika 2, në: https://www.unodc.org/documents/justice-and-prison-reform/GA-RESOLUTION-E_ebook.pdf.

²⁷ Rregullat e Kombeve të Bashkuara për Mbrojtjen e të Miturve të Privuar nga Liria, pika A, Rregulli 19, në: https://www.ohchr.org/Documents/ProfessionalInterest/res45_113.pdf.

ankese me pretendimin se AK ka bere shkelje gjate vlerësimit të ofertave. Autoriteti Kontraktues ka shqyrtuar pikat e ankesës duke konstatuar se AK nuk ka bërë shkelje por vlerësimin e ka bere në harmoni me LPP-në. Lidhur me këtë operatori ekonomik ka bere ankeze në Organin Shqyrtues te Prokurimit (OSHP). Meqenëse OSHP nuk ka bord ne nuk po kemi mundësi qe te vazhdojmë me ketë proces te prokurimit.”

71. Ndërsa sa i përket rritjes se stafit korrektues, MKPT-ja u njoftua nga ShKK-ja, si në vijim: “*Lidhur me numrin e stafit korrektues në Qendrën Korrektuese në Dubravë SHKK është në procedurë të regrutimit të 30 zyrtarëve të rinj për këtë qendër, procedura tani është në fazën e ankesave.*”

Shërbimi social në QKD

72. Ekipi i MKPT-së gjatë vizitës në QKD ka marrë ankesa për shërbime joefektive sociale të ofruara nga punëtorët socialë. Lidhur me këtë, MKPT-ja ka biseduar me punëtorët socialë të cilët kanë pohuar se për shkak të numrit të vogël të punëtorëve socialë nuk po mund të janë efektiv në punë. Sipas tyre, numri i punëtorëve socialë mbetet shumë i vogël në krahasim me numrin e të burgosurve dhe ata vazhdojnë të janë të mbingarkuar me punë administrative.
73. Po ashtu MKPT-ja gjatë monitorimit pranoi ankesa nga të dënuarit edhe për zyrtarët ligjorë me pohimet se kontakti me zyrtarin ligjor është i vështirë. Lidhur me këtë, MKPT-ja ka biseduar me zyrtarin ligjor që ishte i pranishëm gjatë monitorimit, i cili pohoi se janë tre zyrtarë ligjorë. Sipas tij, ky është një numër i vogël i zyrtarëve ligjorë në raport me të dënuarit dhe mbingarkimi i tyre me punë po ndikon në komunikimin e tyre me të dënuarit.

Kontakti me botën e jashtme

74. Sa i përket kontaktit me botën e jashtme, legjislacioni në fuqi²⁸, në rastin e personave të dënuar, përcakton se të burgosurit e dënuar kanë të drejtë të pakufizuar për korrespondencë (që u nënshtrohen përjashtimeve të caktuara), kanë të drejtë për një vizitë në muaj, e cila zgjat më së paku një orë, si dhe për vizitë nga fëmijët dhe bashkëshortet e tyre, së paku një herë në 3 muaj, me kohëzgjatje minimale prej tri orësh.
75. Përveç kësaj, ata kanë të drejtë për të bërë thirrje telefonike. Bazuar në intervistat me të dënuarit, atyre u mundësohen vizitat familjare si dhe vikendet. Lidhur me thirrjet telefonike, Udhëzimi Administrativ për Rendin Shtëpiak në Institucionet Korrektuese²⁹ përcakton se i dënuari ka të drejtë për biseda telefonike me anëtarët e familjes së ngushtë dhe me personat e tjerë. Sipas këtij udhëzimi, biseda telefonike e personit të dënuar dhe i të paraburgosurit nuk mund të jetë më e gjatë se 15 minuta.
76. Të dënuarit gjëzojnë të drejtën për telefonata, varësisht nga regjimi, ndërsa në pavijone të caktuara telefonatat janë të pakufizuara. Në rastin e të paraburgosurve, neni 200 i Kodit të Procedurës Penale të Kosovës përcakton se të paraburgosurit mund të pranojnë vizita “*brenda kufijve të rregullave të qendrës së paraburgimit*” bazuar në lejen e gjyqtarit të procedurës paraprake dhe nën mbikëqyrjen e tij.

²⁸ Ligji për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, nenet 62-65.

²⁹ Udhëzimi Administrativ për Rendin Shtëpiak në Institucionet Korrektuese, neni 54.

77. Më tej ky kod përcakton se korrespondenca dhe vizitat e tjera i nënshtrohen vendimit të gjyqtarit të procedurës paraprake. Bazuar në intervistat me të paraburgosurit, del se atyre u mundësohen dy vizita në muaj sipas lejes së gjykatës dhe një vizitë shtesë nga drejtori, bazuar në kërkesën e parashtruar nga i paraburgosuri në rrethana të caktuara.
78. Avokati i Popullit ose përfaqësuesit e tij mund t'i vizitojnë të paraburgosurit dhe të korrespondojnë me ta pa paralajmërim paraprak dhe pa mbikëqyrjen e gjyqtarit të procedurës paraprake, të gjyqtarit të vetëm gjykues apo të kryetarit të trupit gjykues ose të personave të tjera të emëruar nga gjyqtari i tillë. Letrat e të paraburgosurit dërguar Institucionit të Avokatit të Popullit nuk mund të kontrollohen. Avokati i Popullit dhe përfaqësuesit e tij mund të komunikojnë gojarisht ose me shkrim në mënyrë konfidenciale me të paraburgosurit. Po ashtu, të dënuarit mund t'i drejtohen MKPT-së së Avokatit të Popullit edhe përmes telefonit.
79. Në rastin e shtetasve të huaj, atyre u ofrohet mundësia që, me shkrim ose me gojë, të kontaktojnë me përfaqësinë diplomatike, apo me zyrën përkatëse të shtetit shtetësinë e të cilët e ka ai/ajo.³⁰ Gjatë vizitës, MKPT-ja ka intervistuar disa shtetas të huaj, të cilët nuk patën asnjë ankesë sa i përket trajtimit në QKD, përkundrazi, ata u shprehën në favor të marrëdhënieve mjaft pozitive, si me zyrtarët korrekta, ashtu edhe me të burgosurit e tjerë.

Procedurat e ankesave

80. Neni 91 i Ligjit për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale përcakton në hollësi procedurën sipas së cilës të paraburgosurit dhe të dënuarit mund t'i drejtohen me ankesë apo me lutje drejtorit të një institucioni të caktuar të Shërbimit Korrekta të Kosovës. Procedura përfshin edhe afatet për përgjigje nga drejtori dhe mundësinë që ankesa t'i drejtohet një autoriteti tjetër, që në rastin e tanishëm janë Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Korrekta dhe Ministria e Drejtësisë.³¹
81. MKPT-ja ka vërejtur se në dispozicion të të burgosurve në QKD janë kutitë e ankesave, të vendosura nga Shërbimi Korrekta të Kosovës, nga DShB-ja dhe nga Institucioni i Avokatit të Popullit. Kutitë e ankesave të vendosura nga Institucioni i Avokatit të Popullit mund të hapen vetëm nga personeli i këtij institucioni, gjë që për ankuesit ofron konfidencialitet në parashtrimin e ankesës.
82. Gjatë vizitës, MKPT-ja mori ankesa nga disa të burgosur për mospërgjigje nga drejtori i QKD-së dhe i ShKK-së lidhur me kërkesat e tyre për transferimin në qendrat e tjera korrekta e lidhur me vikendet. Lidhur me këtë, MKPT-ja ka kërkuar komentet e drejtorit të QKD-së. Sipas drejtorit, bëhen përpjekje maksimale për ta përmbyllur këtë obligim ligjor dhe se zyrtarëve kompetentë sërisht do t'u dërgohen udhëzime të qarta që, pa vonesa, ta plotësojnë këtë obligim ligjor.

³⁰ Ligji për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, nen 33, paragrafi 1.

³¹ Neni 91, paragrafi 4, i Ligjit për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale përcakton: “Në ankimin e paragjitur drejtori i institucionit korrekta do të përgjigjet në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh, ndërsa Zyra Qendrore e Shërbimit Korrekta do të përgjigjet në afat prej tridhjetë (30) ditësh. Në ankimin me shkrim do të jepet përgjigja në formën me shkrim.”

83. Në bazë të të gjeturave dhe të konstatimeve të MKPT-së gjatë vizitës, në pajtim me nenin 135, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe me nenin 17, paragrafi 7, të Ligjit 05/L-019 për Avokatin e Popullit, Avokati i Popullit i

REKOMANDON


Ministrisë së Drejtësisë:

- Të përmirësohet cilësia e ushqimit dhe të evitojë mangësitë në pajisjet teknike në kuzhinë (shih paragrafët 21 dhe 24).
- Të dënuarit të furnizohen mjaftueshmë me ujë të ngrohtë dhe me dyshekë cilësorë.
- Të kryhen rinoime në Punëtorinë nr. 1 dhe të krijohen kushte adekuate të punës në të gjitha punëtoritë.
- Të organizohen kurse të veçanta për të burgosurit që nuk dinë shkrim-lexim.
- Të krijohen kushte adekuate për të hospitalizuarit në spitalin e burgut.
- Të rritet numri i punëtorëve socialë, i zyrtarëve ligjorë dhe i personelit tjeter, sipas vlerësimit dhe nevojës.

Ministrisë së Shëndetësisë:

- Të asgjësohen barnat me afat të skaduar.

Në pajtim me nenin 132, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (“*Çdo organ, institucion ose autoritet tjeter, që ushtron pushtet legjitim në Republikën e Kosovës, është i detyruar t'u përgjigjet kërkesave të Avokatit të Popullit dhe t'i paraqesë atij/asaj të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuaara në pajtim me ligj*”) dhe me nenin 28 të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit (“*Autoritetet, të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar rekomandim, kërkesë ose propozim për ndërmarrjen e veprimeve konkrete, përfshirë edhe masat disiplinore, duhet të përgjigjen brenda afatit tridhjetë (30) ditor. Përgjigjja duhet të përbajë arsyet me shkrim për veprimet e ndërmarra lidhur me çështjen në fjalë*”), ju lutemi mirësish të na informoni për veprimet e ndërmarra lidhur me çështjen në fjalë.

Me nederime,

Naim Qelaj
Avokat i Popullit